VENDIM
Nr.552, datë 26.8.1996

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË, NË KUADRIN E PROJEKTIT TË ADMINISTRIMIT TË LIQENIT TË OHRIT

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të miratojë memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë, mbi projektin e ruajtjes së liqenit të Ohrit, të mbështetur nga Banka Botërore dhe të financuar nga Global Environmental Facility (GEF).

2. Të autorizojë Ministrin e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, ose personin e ngarkuar prej tij, të nënshkruajë këtë memorandum mirëkuptimi.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Ambientit, për ngritjen dhe organizimin e grupeve të mëposhtme:

1. Bordi i administrimit të liqenit të Ohrit (pjesa shqiptare);
2. Njësia e Zbatimit të Projektit (PIU);
3. Grupi i monitorimit;
4. Grupi i ndërgjegjësimit publik;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi